



HAXHI ARIFI – Drejtor

Haxhi Arifi ka lindur më 1 korrik 1949. Diplomoi si ekonomist i lart / agrobiznes në universitetin e bujqësisë, fakulteti i bujqësisë në Tiranë në vitin 1955. Nga viti 1976 deri 1989 ka punuar si shef i departamentit për fermentim të alkoolit në fabrikën e birrës / alkoolit të quajtur “Birra Peja”. Nga viti 1996 deri 2006 ishte kryetar i bashkimit të sindikatave të pavarura të Kosovës Agrokompleksi ITUKA. Nga viti 2007 deri 2008 punoi si menaxher i projektit në EAR “Projekti për mbështetje të minoriteteve në BSPK”.

Gjatë karrierës së tij, ai morri pjesë në disa trajnime siç janë: trajnimi për menaxhim të ndërmarrjeve apo institucioneve nën menaxhim të Z. Erhard Busek; trajnim për drejtat e sindikatave duke përfshirë programin Themelimi i Drejtave të Sindikatave në Vendet e Reja të Evropës Qendrore dhe Juglindore nën mbështetjen e Nismës Evropiane për Demokraci dhe Drejta të Njeriut; trajnim mbi ligjin e sindikatave në Zvicër, ligjin e punës, kontratat kolektive, sigurimin shëndetësor në Zvicër dhe ligjin zviceran për të huaj dhe bazat e ekonomisë së tregut dhe politikat ekonomike. Aktualisht punon si kryetar i bashkimit të sindikatave të Kosovës.